



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court  
Adresa: Perandori Justinian, PN, Prishtinë  
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)

Prishtinë, datë: 25 janar 2010  
Ref.: Nr. RK-03/10

## VENDIM

### Rasti Nr. KI 10/09

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke vepruar përmes Panelit Shqyrtues të përbërë nga:

Z. Almiro Rodrigues, Kryetar dhe  
Znj. Snezhana Botusharova, Gjyqtare dhe  
Znj. Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare

me procesmbajtësin, Z. Naser Hasani, Drejtor i Regjistrimit të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv në Sekretarinë e Gjykatës dhe Z. Robert Carolan, Gjyqtar Raportues, në mbledhjen e 24 nëntorit 2009 shqyrtoi kërkesën Nr. KI 10/09 të parashtruar në Gjykatë më 9 mars 2009, ku:

#### **Parashtruesi i Kërkesës është**

Avdullah Beqiri  
Lagjja e vreshtave  
Rr. E Ulqinit p.n., Prishtinë  
Tel: 038 254 352  
044 836 541

#### **dhe Pala kundërshtare është**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

#### **I. Subjekti i çështjes**

Më 26 nëntor 2004 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) fillimisht aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për pranueshmërinë e përfitimeve të invaliditetit retroaktivisht nga 1 janari 2004 në vlerë prej 40 Euro për muaj. Vendimi i bëri të ditur parashtruesit se ajo do të shqyrtohet pas pesë vjetësh. Pastaj në vendimin e datës 13 dhjetor 2006 (nr. 50116335) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i anuloi përfitimet pensionale të parashtruesit të kërkesës sepse MPMS gjeti se gjendja fizike, ndijore dhe mentale e parashtruesit nuk e kualifikojnë atë për pension invalidor. Pastaj parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj këtij vendimi. Më 13 shkurt 2007 ky vendim u konfirmua nga Këshilli për Ankesa

mbi Pensionet invalidore përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas **nenit 10 të Ligjit nr. 2000/23 mbi Pensionet Invalidore** në Kosovë. Pastaj parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj këtij vendimi të pafavorshëm. Më 24 dhjetor 2007 Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ankesa dhe padia e parashtruesit ishin të pabaza dhe duke u bazuar në të gjeturat se parashtruesi nuk kishte përmbushur kriteret e **nenit 3 të Rregullores së UNMIK nr.2003/40** të datës 27 tetor 2004 të **Ligjit mbi Pensionet Invalidore** dhe të opinionit të Këshillit të Mjekëve, si autoritet i shkallës së parë, të datës 8 nëntor 2004 i cili nxori përfundimin se parashtruesi nuk ka paaftësi të përhershme. Në *aktgjykimin Nr.1561/2007* të Gjykatës Supreme të Kosovës, në mënyrë specifike thuhet se autoritet administrative me korrektësi kanë zbatuar dispozitat e **nenit 3 të Rregullores së UNMIK nr.2003/40**.

**Rregullorja e UNMIK nr.2003/40** kërkon që parashtruesi për pagesë të paaftësisë të ofrojë:

- (1) Nëse ata mund ose nuk mund të jenë punësuar në ndonjë kapacitet të cilin e mundësojnë rrethanat e plota të sëmundjes ose paaftësisë së tyre,
- (2) Nëse parashtruesi ka qenë plotësisht i paaftë për një vit e më tepër, kohë gjatë së cilës parashtruesi ishte i paaftë me shëndet për punësim me kompensim, dhe
- (3) Një prognozë për paaftësinë e përhershme.

**Neni 1.5 i kësaj Rregulloreje** përcakton paaftësinë e përhershme dhe të përgjithshme si:

“...diagnozën mjekësore të gjendjes fizike, ndijore, ose mendore, ka sëmundje ose aftësi të kufizuar që e bëjnë atë të paaftë për çfarëdo pune shpërblyese dhe kur Ministria e vlerëson personin dhe vendos se ata/ato i përmbushin kriteret e parapara në këtë ligj”.

Parashtruesi i kërkesës Avdullah Beqiri ka dorëzuar disa nga regjistrimet e tij mjekësore. Këto regjistrime tregojnë se ai vuan nga një sëmundje koronare e zemrës dhe prandaj ai ka marrë kurimin e duhur për atë sëmundje. Tretmani ka përfshirë operacionin e suksesshëm të bypasit. Asnjë nga këto incizime nuk tregon se parashtruesi, Avdullah Beqiri, nuk mund të punojë me kompensim edhe as nuk sugjerojnë që ai ishte i paaftë me shëndet për të punuar me kompensim për një vit e më tepër. Asnjë nga këto incizime nuk sugjeron se ai ka një paaftësi të përhershme.

## II. Pohimet e parashtruesit

Parashtruesi pohon se Vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës shkel **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**. Ai nuk specifikon saktësisht se cila dispozita të **Kushtetutës** shkelen.

## III. Përgjigja e palës kundërshtarë ose palëve të tjera të interesuara

As Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe as Gjykata Supreme e Kosovës nuk kanë dhënë përgjigje formale.

Autoritet qeveritare dhe Gjykata Supreme duket se besojnë se:

- (1) parashtruesi i kërkesës nuk e ka vërtetuar që ai është invalid siç është e përcaktuar me ligjin e aplikueshëm, dhe

- (2) atij i është dhënë një mundësi e drejtë dhe e plotë për të paraqitur kërkesën e tij, dhe një mundësi e drejtë për t'u ankuar dhe për të kërkuar një gjykim të drejtë për ankesën e tij ndaj vendimit të pafavorshëm të Ministritë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pas dëgjimit të gjyqtarit raportues, Z. Robert Carolan, dhe pozicioneve të palëve siç përshkruhet në dokumentet e lëndës gjyqësore lidhur me kërkesën, dhe pas diskutimit të çështjes në tërësi në shqyrtimin e datës 24 nëntor 2009, Gjykata gjen dhe nxjerr përfundimin se:

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesë**

**Neni 51 i Kushtetutës** thotë:

1. "Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj."
2. "Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj."

**Neni 54 i Kushtetutës** thotë:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur."

Parashtruesi i kërkesës, Avdullah Beqiri, duket se mbështetet në dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës për ta mbështetur kërkesën e tij, por nuk pohon në mënyrë të veçantë se cilat dispozita të Kushtetutës mbështesin kërkesën e tij.

Duket se parashtruesi i kërkesës ka shteruar të gjitha mjetet e ofruara me ligj që është një parakusht për të fituar të drejtën e bërjes së pranueshme të një Kërkesë në Gjykatë. **Shih paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**

Ankesa e parashtruesit të kërkesës është e kufizuar në mospajtimet e tij me konkluzionet e veprimeve administrative të bëra për shkak të fakteve të kërkesës së tij individuale dhe spekulimit të tij se këto veprime nuk marrin në konsideratë në mënyrë të drejtë të gjitha provat relevante për të vlerësuar kërkesën e tij që ai beson se nuk ka pasur një mjet efektiv juridik për të drejtën e tij për paaftësi siç është e siguruar dhe rregulluar me ligj. **Shih nenet 51 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**

Parashtruesi i kërkesës ka marrë një seancë të drejtë dhe të plotë administrative, siç ka pasur gjithashtu edhe një ankesë të drejtë dhe të plotë administrative për atë vendim. Gjykata Supreme thellësisht ka rishikuar ankesën e parashtruesit dhe me saktësi ka vlerësuar atë duke ardhur në përfundimin e duhur se ligji i aplikueshëm për pohimet e paaftësisë ishte aplikuar në rastin e tij dhe se atij i ishte lejuar një seancë e plotë lidhur me pohimet e tij. *Prandaj Kërkesa është e papranueshme dhe duhet të refuzohet.*

### Vlerësimet e pikëpamjeve të pavarura ligjore të Kërkesës

Nuk ka asnjë bazë substanciale ligjore për Kërkesën e parashtruesit sepse sipas ligjit të aplikueshëm lidhur me pohimet për paaftësi, atij i është lejuar një seancë e plotë dhe e drejtë lidhur me kërkesat për paaftësi. *Prandaj Kërkesa duhet të refuzohet.*

#### PËR KËTO ARSYE GJYKATA MORI VENDIMIN E SAJ DHE VENDOSI:

- I. Të shpallë si të papranueshme kërkesën lidhur me pohimet e parashtruesit të kërkesës për përfitime të paaftësisë nga data 1 janar 2004 e deri më tani, dhe
- II. Të njoftojë parashtruesin e kërkesës, Z. Avdullah Beqiri, palën kundërshtare, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe për qëllim të informimit, Gjykatën Supreme të Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Robert Carolan, d.v.  
Gjyqtar Raportues



Enver Hasani, d.v.  
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese